

<b>RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	
<b>EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	Projektligj për “Për disa ndryshime në ligjin nr.9584, datë 17.07.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar”
<b>MINISTRIA UDHËHEQËSE</b>	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
<b>FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Finale
<b>BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS</b>	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
<b>DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së</b>	Jo e zbatueshme
<b>PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA</b>	Jepni titullin e strategjisë ose të dokumentit të politikave që ka të bëjë me projektligjin.
<b>DATA E KONSULTIMIT PUBLIK</b>	Data/Asnjë konsultim publik
<b>DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	11/02/2023
<b>A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT</b>	Po/Jo Data e shqyrtimit
<b>NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT</b>	Viti– ML – Nr. VN
<b>TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)</b>	
<b>PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)</b>	
<p><b>PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT</b></p> <p><i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i></p> <p>Nisma për ndryshimin e ligjit nr. 9584/2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” ka si një ndër shkaqet kryesore zbatimin e vendimit nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetues. Shkronja "a", e pikë 5, të neni 12, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar referonte në pagën e nëpunësve civil, referim i cili solli probleme në zbatimin e duhur në praktikë dhe përlllogaritjen e pagës së magjistratit (të dispozitave mbi caktimin e pagës së rezultatit). Në vijim të këtyre problematikave, pas kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë kjo dispozitë u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 35/2022.</p> <p>Në vendimin e saj GJK u shpreh se "Gjykata vlerëson të theksojë se ligjvënësi, brenda hapësirës së tij normuese, në formulimin e normës së re ligjore për pagën e magjistratit ka diskrecionin t'i referohet formulës aktuale të referencës në shërbimin civil ose çdo formule tjetër që referon në legjislacionin në fuqi për pagat e funksionarëve publikë, duke qenë kjo një çështje që i përket oportunitetit të tij. Megjithatë, në ushtrim të kompetencave të tij, në plotësimin e kuadrit ligjor ai duhet të mbajë parasysh përcaktimet e nenit 138 të Kushtetutës, duke garantuar, në çdo rast, që paga dhe përfitimet e tjera që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të sistemit të referencës së pagave, të mos</p>	

*ulen nën standardin e analizuar në këtë vendim, përveçse kur verifikohet përjashtimi i nenit 138, shkronja "a", të Kushtetutës."*

Me qëllim zbatimin e vendimit të mësipërm, si dhe për shkak se funksioni i magjistratit është një funksion kushtetues dhe pagat e tij duhet të lidhet po me një funksion kushtetues për të ruajtur kështu dhe parimin e hirearkisë së paga. Për këtë arsye referenca në pagën e Presidentit të Republikës është më e përshtatshme, njësoj si funksionarët e tjerë më të lartë shtetërorë, referimi i të cilëve bëhet me pagën e Presidentit të Republikës.

Ligji nr. 9584/2006 duhet të garantojë edhe një hierarki të drejtë të pagave të funksionarëve më të lartë shtetërorë duke u bazuar në rëndësinë e funksioneve të tyre. Në kushtet kur në vijim të reformës në drejtësi paga e magjistrati aktualisht tejkalon pagën bruto të Presidentit është e nevojshme të rritet paga e Presidentit të Republikës në mënyrë që të ruhet hierarkia e tyre.

Ndërkohë, ligji nr. 9584/2006, i miratuar në muajin korrik të vitit 2006, kishte si synim në atë kohë, ndërmjet të tjerave, të përcaktonte raportet e pagave të titullarëve dhe anëtarëve të organeve kolegjiale me kohë të plotë për disa institucione kushtetuese dhe institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj. Gjithashtu, në këtë ligj përcaktohet që paga më e lartë në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit.

Për përcaktimin e raporteve në atë moment nuk pati një studim që të vlerësonte hierarkinë e këtyre pozicioneve, bazuar në rëndësinë e institucioneve, e për këtë arsye në lidhjen që i bashkëlidhet ligjit u vendosën raportet që dilnin në bazë të niveleve të pagave të atij momenti. Pra raportet e miratuara aktualisht nuk shprehin në thelb një hierarki të mirëstrukturuar të pozicioneve të administratës publike.

Gjithashtu, ndër vite, që nga viti 2006, kanë ndodhur disa ndryshime ligjore, që ndikojnë në fushën e veprimit të ligjit aktualisht në fuqi, ku mund të përmendim: (i) vendimin e Gjyaktës Kushtetuese të vitit 2007 që e shfuqizoi ligjin për disa institucione kushtetuese (pasi në ligjet për këto institucione, ligje të miratuara me shumicë të cilësuar, kishte përcaktime në lidhje me pagat e tyre); (ii) miratimin e ligjeve të reja për disa nga institucionet, pjesë e fushës së veprimit të ligjit aktualisht në fuqi, ku në disa raste kanë ndryshuar emërtimet e institucioneve dhe në disa raste ato janë hqur nga fusha e tij e veprimit.

## **OBJEKTIVAT**

*Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)*

Ky projektligj, synon të vendos hirearkinë e pagave ndërmjet funksionarëve më të lartë shtetërorë duke rivendosur pagën e Presidentit si pagën më të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Projektligj synon të zbatojë me korrektësi të vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese.

Gjithashtu ky projektligj synon të bëjë përmirësimin e raportit të pagave të titullarëve dhe të anëtarëve të organeve kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të disa institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj.

## **OPSIONET E POLITIKAVE**

*Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)*

**Opsioni 0-** Status Quo. Ky opsion nuk adreson asnjë nga problematikat që synon të adresojë ky ligj. **Opsioni i parë** është të ndryshojmë në tërësi ligjin duke e ribërë nga e para. Ky opsion nuk është zgjidhja optimale pasi përcaktimet aktuale nuk pësojnë asnjë ndryshim nga ekzistuesi. I vetmi ndryshim i ligji ekzistues është lidhja e koeficientëve. Si rezultat, **Opsioni i dytë** për të realizuar objektivin e përmendur më sipër është ndryshimi i ligjit nr. 9584/2006, të ndryshuar dhe jo hartimi i një ligji të ri.

Ndryshimi i ligjit do t'i hapte rrugë zbatimit të vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese, si dhe realizimit të reformës së pagave për disa grupe të tjera të nëpunësve dhe punonjësve të administratës publike, duke krijuar hierarkinë e pagave (e cila ndër vite për shkak të rritjeve sipas sistemeve prioritare është "prishur").

## **ANALIZA E NDIKIMEVE**

*Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)*

Miratimi i ndryshimeve të propozuara në projektligj do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbatimin e vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese, në krijimin e një hierarkie më të mirë të pagave të titullarëve dhe anëtarëve të organeve kolegjiale me kohë të plotë të disa institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjeratë pavarura të krijuara me ligj, dhe gjithashtu do të krijonte mundësinë e krijimit të një hierarkia të mirë të pagave për të gjithë nëpunësit dhe punonjësit e administratës publike.

Ndërkohë, miratimi i këtij projektligji do të sillte si pasojë rritjen e pagave të Presidentit dhe titullarëve e anëtarëve me kohë të plotë të organeve kolegjiale drejtuese të disa institucioneve kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj.

Në mënyrë të drejtpërdrejtë nga miratimi i këtij projektligji, përfitojnë rreth 25 funksionare t ë cilët pagën e kanë të lidhur me pagën e Presidentit dhe efekti financiar vjetor shtesë që vjen nga kjo skemë e re vetëm për këtë kategori përllorarit 20-30 milion lekë. Theksojmë që për magjistratët objekt jo i drejtpërdrejtë I këtij ligji nuk ka kosto financiare shtesë pasi koeficienti i propozuar i magjistratit kundrejt Pagës së Rishikuar të Presidentit ruan pothuajse të njëjtën vlerë me atë të vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

#### **ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR**

*Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)*

Zgjedhja e opsionit për të ndryshuar ligjin nr. 9584/2006, të ndryshuar është mundësia e më e mirë për të realizuar objektin e qeverisë shqiptare për krijimin e hierarkisë së pagave dhe adresimin e vendimit nr.35 të Gjykatës Kushtetuese.

**Kostoja e përlloritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):**

<b>Viti 1</b>	<b>Viti 2</b>	<b>Viti 3</b>
<b>13 000 000</b>	<b>20 000 000</b>	<b>20 000 000</b>

#### **KONSULTIMI**

*Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)*

Projektligji është përgatitur në grup pune dhe konsultuar me Departamentin e Administratës Publike, si institucioni përgjegjës për përgatitjen dhe propozimin e politikave të pagave.

#### **ZBATIMI DHE MONITORIMI**

*Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)*

Zbatimi dhe monitorimi i përcaktimeve të këtij ligji do të bëhet nga Drejtoritë përkatëse të Institucioneve të Pavarura objekti I këtij ligji si dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## **PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE**

### **Historik**

*Jepni kontekstin e politikës.*

Në kuadër të raportimeve të qeverisë shqiptare në Grupin e Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE – Shqipëri (PAR – SG), një ndër rekomandimet e lëna është edhe reformimi i sistemit të pagave. Për realizimin e këtij objekti është punuar gjatë katër viteve dhe në bashkëpunim me DAP-in janë ndërmarrë reforma pjesore për rritjen e pagave të sistemeve prioritare. Sic u shpjegua edhe me sipër, aktualisht jemi në fazën kur ndërhyrja thelbësore për realizimin e kësaj reforme është e lidhur ngushtësisht me ndryshimin e ligjit nr. 9584/2006, të ndryshuar. Një ndër mënyrat e zbatimit të vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese është edhe krijimi i një sistemi të ri referimi të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në raport tashmë me pagën e Presidentit të Republikës..

### **Problemi në shqyrtim**

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Shkruani tekstin këtu.

- *Përshkruani natyrën e problemit*

Nisma për ndryshimin e ligjit nr. 9584/2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” ka si një ndër shkaqet kryesore zbatimin e vendimit nr. 35/2022 të Gjykatës Kushtetues. Shkronja "a", e pikë 5, të neni 12, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar referonte në pagën e nëpunësve civil, referim i cili solli probleme në zbatimin e duhur në praktikë dhe përlllogaritjen e pagës së magjistratit (të dispozitave mbi caktimin e pagës së rezultatit). Në vijim të katër problematikave, pas kërkesës së Unionit të Gjyqtarëve të Shqipërisë kjo dispozitë u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 35/2022.

Në vendimin e saj GJK u shpreh se "Gjykata vlerëson të theksojë se ligjvënësi, brenda hapësirës së tij normuese, në formulimin e normës së re ligjore për pagën e magjistratit ka diskrecionin t`i referohet formulës aktuale të referencës në shërbimin civil ose çdo formule tjetër që referon në legjislacionin në fuqi për pagat e funksionarëve publikë, duke qenë kjo një çështje që i përket oportunitetit të tij. Megjithatë, në ushtrim të kompetencave të tij, në plotësimin e kuadrit ligjor ai duhet të mbajë parasysh përcaktimet e nenit 138 të Kushtetutës, duke garantuar, në çdo rast, që paga dhe përfitimet e tjera që vijnë si rrjedhojë e zbatimit të sistemit të referencës së pagave, të mos ulen nën standardin e analizuar në këtë vendim, përveçse kur verifikohet përjashtimi i nenit 138, shkronja “a”, të Kushtetutës."

Me qëllim zbatimin e vendimit të mësipërm, si dhe për shkak se funksioni i magjistratit është një funksion kushtetues dhe pagat e tij duhet të lidhet po me një funksion kushtetues për të ruajtur kështu dhe parimin e hirearkisë së paga. Për këtë arsye referenca në pagën e Presidentit të Republikës është më e përshtatshme, njësoj si funksionarët e tjerë më të lartë shtetërorë, referimi i të cilëve bëhet me pagën e Presidentit të Republikës.

- *Identifikoni shkaqet e problemit*

Ligji nr. 9584/2006, i ndryshuar ka të përcaktuar që paga më e lartë në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës. Gjithashtu, nëpërmjet këtij ligji është tentuar përcaktimi i hierarkisë së pagave për titullarët e institucioneve të pavarura, gjë që ndikon edhe në hierarkinë e pjesës tjetër të pozicioneve të punës në administratën publike. Për shkak të rritjeve ndër vite të pagave sipas sistemeve, aktualisht jemi në situatën kur çdo rritje e mëtejshme e pagave pa ndryshuar ligjin nr. 9584/2006, të ndryshuar, do të përkeqësonte edhe më tej hierarkinë aktuale.

- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*

Ndryshimi i këtij ligji prek në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë funksionarët më të lartë shtetërore dhe në mënyrë indirekte të gjithë magjistratët.

- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët*

Të gjitha nivelet e funksionarëve më të lartë shtetërore dhe në mënyrë indirekte të gjithë magjistratët.

- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave*

Problemi mund të trajtohet vetëm nëpërmjet ndryshimit të ligjit nr. 9584/2006, të ndryshuar.

### **Arsyeja e ndërhyrjes**

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Shkruani tekstin këtu.

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë*

Ligji nr. 9584/2006, i ndryshuar ka të përcaktuar që paga më e lartë në Republikën e Shqipërisë është paga e Presidentit të Republikës. Aktualisht paga e magjistratit e tejkalon Pagën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Prandaj qeveria synon të ndërhyjë për të rivendosur hirearkinë e pagave duke ruajtur përcaktimin e këtij ligji dhe lidhja e llogaritjes së pagës së magjistratit me një funksion kushtetues si ai i Presidentit.

- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje*

Ruajtja e Hirearkisë së Pagave për funksionet më të larta shtetërore, përmirësimi i raporteve të pagave të titullarëve dhe anëtarëve të organeve kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuar me ligj dhe zbatimimi i vendimit nr.35/2022, të Gjykatës Kushtetuese.

- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë*

Miratimi i këtij projektligji krijon kushtet për zbatimin e mëtejshëm të reformës së pagave, një ndër rekomandimet e lëna nga Grupi i Posaçëm për Reformën e Administratës Publike BE – Shqipëri (PAR – SG).

- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë*

Është bërë një studim krahasues i pagavë aktuale të magjistratit me ato të funksionarëve më të lartë shtetëror. Rezultoi se paga e tyre tejkalon pagën e Presidentit dhe për pasojë të të gjitha funksioneve të tjera. Në kushtet kur ligji 9584 i ndryshuar përcakton që paga më e lartë në RSH është ajo e Presidentit si dhe të ndodhur para faktit të nevojës së zbatimit të Vendimit nr.35 të Gjykatës Kushtetuese u ndërmorr iniciativa për rishikimin e lidhjes duke vendosur një pagë të re të Presidentit e cila gjithashtu do të propozohet për ta lidhur me pagën e magjistratit. Kjo lidhje e re e propozuar korrekton marrëdhënien e pagës së magjistratit duke e lidhur me një funksion kushtetues pra të të njëjtit nivel e duke hequr lidhjen me funksionet administrative sikurse është sot. Paga e magjistratit e lidhur me pagën e rishikuar të Presidentit ruan të njëjtin nivel sikurse është sot.

## **Objektivi i politikës**

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Ky projektligj, synon të vendos hirearkinë e pagave ndërmjet funksionarëve më të lartë shtetërore duke rivendosur pagën e Presidentit si pagën më të lartë në Republikën e Shqipërisë. Projektligj synon të zbatohet me korrektësi të vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu ky projektligj synon të bëjë përmirësimin e raportit të pagave të titullarëve dhe të anëtarëve të organeve kolegjiale drejtuese me kohë të plotë të disa institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj.

## **Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara**

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Mos ndryshimi i ligjit nr. 9584/2006, të ndryshuar nuk është një opsion, pasi siç është shpjeguar edhe më sipër, vlerat aktuale të niveleve të pagave të Presidentit të Republikës dhe titullarët e institucioneve të pavarura, nuk mundësojnë: (i) krijimin e një sistemi të ri referimi (me Presidentin e Republikës) për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) etj). Opsioni i hartimit të një ligji të ri nuk rezulton eficient pasi përcaktimet aktuale nuk ndryshojnë pranda, opsioni më i preferuar është ndryshimi i ligjit nr. 9584/2006, i ndryshuar pasi nëpërmjet tij realizohet ndryshimi i lidhjes së koeficientëve. .

## **Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve**

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni nga ana sasimore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
  - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
  - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
  - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
  - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
  - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
  - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
  - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
  - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Grupet e prekura direkt nga ky projektligj janë: (i) Presidenti i Republikës dhe titullarët dhe anëtarët me kohë të plotë të organeve kolegjiale drejtuese të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj.

(ii) gjyqtarët dhe prokurorët, pasi sic e kemi shpejguar miratimi i këtij projektligji do të mundësonte zbatimin e vendimit nr. 35/2022, të Gjykatës Kushtetuese, duke miratuar një sistem të ri referimi të pagës bazë të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Kosto financiare shtesë për vitin 2023 duke filluar nga data 1 Prill 2023 përlllogaritet 13 milionë lekë;
- Kosto financiare shtesë për vitin 2024 e në vijim përlllogaritet 20 milionë lekë;

Në shtojcën 2/a është paraqitur vlera aktuale neto e kostot financiare shtesë të projektligjit për 10 vite. Në pjesën e parë të tabelës janë paraqitur kostot e ndara për buxhetin dhe për grupet e tjera të cilat në këtë rast janë funksionarë më të lartë shtetëror. Kosto për individin mban në konsideratë ndalesat mbi pagën bruto (TAP, Sigurimi shoqëror dhe shëndetësor) të cilat duke mbajtur në konsideratë raportin midis pagës neto/pagës bruto në administratën publike është përlllogaritur rreth 20% e fondit të rritur të pagave. Pjesa e mbetur prej 80% e koston, ose fondi i pagave neto, është shënuar si kosto për buxhetin duke qënë që është vlera përfundimare që përfitojnë punonjësit.

Po kështu, edhe në pjesën e dytë të tabelës në të cilën është përlllogaritur përfitimi, fondi i pagave neto është shënuar si përfitim për individët (në këtë rast funksionarë më të lartë shtetëror) ndërsa pjesa e ndalesave mbi pagën bruto është shënuar si përfitim për buxhetin e shtetit.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Pavarësisht se në të dyja opsionet, vlera aktuale neto del 0, opsioni i preferuar është përzgjedhur ndryshimi i ligjit nr. 9584/2006, pasi me ndryshimet e propozuara mundësohet: (i) krijimi i një sistemi të ri referimi (me Presidentin e Republikës) për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) zbatimi korrekt i Vendimit nr.35 të Gjykatës Kushtetuese.

### **Çështje të zbatimit**

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Zbatimi dhe monitorimi i përcaktimeve të këtij ligji do të bëhet nga Drejtoritë përkatëse të Institucioneve të Pavarura objekti I këtij ligji si dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

### **Faza e monitorimit dhe vlerësimit**

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Zbatimi dhe monitorimi i përcaktimeve të këtij ligji do të bëhet nga Drejtoritë përkatëse të Institucioneve të Pavarura objekti I këtij ligji si dhe nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

*Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.*

Në 000/lekë

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
<b>Faktori zbritës</b>	1.00	0.95	0.91	0.87	0.82	0.79	0.75	0.71	0.68	0.65
<b>Kosto për buxhetin – ne vazhdimi</b>	10,400	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000
Kosto për biznesin – një herë	-									
Kosto për biznesin – në vazhdim	-	-	-							
Kosto për grupet e tjera – një herë	2,600	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
<b>Kosto në total</b>	13,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
<b>Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës</b>	13,000	19,057	18,158	17,301	16,485	15,708	14,967	14,261	13,588	12,948
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim	2,600	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim	-	-	-			-	-	-	-	-
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë	-	-	-			-	-	-	-	-
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim	10,400	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000	16,000
<b>Përfitimi për buxhetin – njëherë</b>	-									
<b>Përfitimi në total</b>	13,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000	20,000
<b>Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës</b>	13,000	19,057	18,158	17,301	16,485	15,708	14,967	14,261	13,588	12,948
<b>Vlera aktuale e kostos në total</b>	155,473									
<b>Vlera aktuale e përfitimit në total</b>	155,473									
<b>Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total</b>	-									



Llogaritjet e kostove janë bërë duke mbajtur në konsideratë një sërë elementësh të pagave të funksionarëve të lartë shtetëror. Detaje të këtyre llogaritjeve për efekt të teknikaliteteve të fushës dhe sasisë së madhe të databazës së të dhënave që është përdorur nuk mund të jepen me detaje në këtë material.

Kostoja për vitin e parë është llogaritur për efekt 8 mujor pra fillon 1 Prilli prandaj rezulton në total 13 milionë lekë. Ndërkohë nga viti 2024 e në vijim kostoja është vjetore në masën 20 milionë lekë.

Gjithashtu është përdorur supozimi që ndalesat e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe TAP do të jenë 20% mbi pagën bruto. Tatimi mbi të ardhurat personal aktualisht është sipas një sistemi progresiv dhe është e pamundur të vendosim këtu llogaritje të pagës dhe ndalesa sipas kategorive të tatimit progresiv, pasi nuk disponojmë të dhëna të detajuara për të gjithë funksionarët që të mund të bëjmë llogaritje në këtë nivel. Përfitojnë 250 funksionarë të lartë shtetëror nga rishikimi i koeficientëve dhe llogaritjet janë bërë mbi këtë numër.

Është supozuar që këto paga nuk indeksohen me inflacionin gjatë këtij 10 vjeçari.

Në pjesën e parë të tabelës janë paraqitur kostot e ndara për buxhetin dhe për grupet e tjera të cilat në këtë rast janë funksionarë më të lartë shtetëror. Kosto për individin mban në konsideratë ndalesat mbi pagën bruto (TAP, Sigurimi shoqëror dhe shëndetësor) të cilat duke mbajtur në konsideratë raportin midis pagës neto/pagës bruto në administratën publike është përlllogaritur rreth 20% e fondit të rritur të pagave. Pjesa e mbetur prej 80% e kostos, ose fondi i pagave neto, është shënuar si kosto për buxhetin duke qënë që është vlera përfundimare që përfitojnë punonjësit. Po kështu, edhe në pjesën e dytë të tabelës në të cilën është përlllogaritur përfitimi, fondi i pagave neto është shënuar si përfitim për individët (në këtë rast funksionarë më të lartë shtetëror) ndërsa pjesa e ndalesave mbi pagën bruto është shënuar si përfitim për buxhetin e shtetit.

## Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

*Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni*

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	155	155	0

Pavarësisht se në të dyja opsionet, vlera aktuale neto del 0, opsioni i preferuar është përzgjedhur ndryshimi i ligjit nr. 9584/2006, pasi me ndryshimet e propozuara mundësohet: (i) krijimi i një sistemi të ri referimi (me Presidentin e Republikës) për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve; (ii) zbatimi korrekt i Vendimit nr.35 të Gjykatës Kushtetuese.

**MINISTËR**

**DELINA IBRAHIMAJ**